



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 14 1 - 7 Prill 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 14

	JAVA 14
DIARRE PA GJAK	1.125
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	8.089
INF. RESP. TE POSHTËME	4.055
RASH ME TEMPERATURË	24
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	423
% e Njësive Raportuese	96% (423/441)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Mat – 2 raste


Elbasan – 1 rast

Tiranë – 20 raste


Vlorë – 1 rast

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën 14 krahasuar me javën paraardhëse, java 13.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën 14 krahasuar me javën paraardhëse, java 13.

Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 05 – 14 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.



Në javën 14 të vitit 2024 vërehet prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


**Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës.
Incidenca (raste/10.000)**



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 13 dhe 14 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




**Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 05 - 14 të viteve 2023 dhe 2024.
Numri i rasteve.**



Në javën 14 të vitit 2024 vërehet në ritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 13 dhe 14 / 2024.
Incidenca (raste/10.000)**



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje ndërkombëtare

1. *Kolera – Komore dhe Majotë – 2024 – Monitorimi javor*

- Më 19 mars 2024, prefekti i Mayotte raportoi rastin e parë të importuar të konfirmuar të kolerës në territorin francez të Mayotte që nga viti 2000. Sipas mediave, rasti u rikuperua dhe asnjë rast tjetër nuk është zbuluar në Mayotte.
- Sipas informacionit të disponueshëm, rreziku i transmetimit nga komuniteti në Mayotte mbetet i lartë.
- Që nga përditësimi i fundit i disponueshëm më 22 mars 2024 dhe që nga 31 marsi, 199 raste të reja të kolerës dhe katër vdekje të reja janë raportuar në Komore. Deri më 31 mars, janë raportuar 655 raste të konfirmuara të kolerës dhe 16 vdekje.

2. *Rastet njerëzore të infektuara me virusin e variantit të gripit të derrit A(H1N2) – Shumë vende – 2023*

- Një rast i ri i infeksionit njerëzor me virusin e variantit të gripit A(H1N2) me origjinë të derrit është raportuar në shtetin e Pensilvanisë, Shtetet e Bashkuara (SHBA). Ky është rasti i parë njerëzor me infeksion të gripit të derrit A(H1N2)v i zbuluar në SHBA këtë vit.
- Më parë, raste të gripit të derrit A(H1N2)v u raportuan në SHBA në vitin 2023 (dy raste), 2022 (gjashtë raste) dhe 2021 (katër raste). Të gjitha rastet ishin nga rajone të ndryshme të SHBA-së dhe konsideroheshin raste sporadike.
- Në përgjithësi, 27 raste janë raportuar globalisht që nga viti 2019, duke përfshirë katër raste të raportuara në vendet e BE/ZEE (Austri, Danimarkë, Francë dhe Holandë). Rasti i fundit në BE/ZEE u raportua në Holandë në vitin 2022. Katër rastet e fundit të raportuara në vitin 2023 ishin nga Tajvani (një rast), Mbretëria e Bashkuar (një rast) dhe SHBA (dy raste).
- Këto ngjarje janë të rralla dhe nuk është zbuluar asnjë transmetim nga njeriu te njeriu.

3. *MERS-CoV – Shumë vende – Përditësim mujor*

- Që nga fillimi i vitit 2024 dhe që nga 3 prilli, asnjë rast MERS-CoV nuk është raportuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ose autoritetet kombëtare shëndetësore.
- Rasti i fundit i raportuar ishte në Arabinë Saudite, me datën e fillimit më 26 tetor 2023.

✓ Perditësimi i situatës globale të gripit të shpendëve 17 Shkurt deri 15 Mars 2024

Sezoni aktual epidemik i HPAI vazhdon me 21 shpërthime të raportuara në shpendë dhe 62 specie të tjera (jo shpende) aktualisht Afrikë, Amerikë, Azi dhe Evropë. Bazuar në modelin e njohur sezonal të sëmundjes normalisht sapo kemi kaluar kulmin e valës globale epidemike, por gjatë muajve të ardhshëm mbetet për t'u konfirmuar ecuria në varesi se si evoluon sëmundja. Pasojat e gripit të shpendëve në jetën e egër mund të çojnë potencialisht në një efekt shkatërrues në biodiversitetin e ekosistemeve tona. Megjithatë numri i shpërthimeve në shpendët pritet të mbetet relativisht e lartë në mbarë botën ende për disa muaj. Përveç kësaj çdo rajon ose nënrajon mund të ketë specifikat e veta sezonale të cilat ndryshojnë nga tendenca e përgjithshme globale. WOAH thekson rëndësinë e raportimit të shpërthimeve të gripit të shpendëve në bujtës të pazakontë, pasi virusi po zbulohet gjithnjë e më shumë tek gjitarët në muajt e fundit. WOAH rekomandon që vendet të vazhdojnë përpjekjet e tyre të mbikëqyrjes, të zbatojnë biosigurinë dhe masat e parandalimit në nivel ferme dhe vazhdimi i raportimit në kohë të shpërthimeve të gripit të shpendëve si në shpendë ashtu edhe në specie jo shpendë. Më 1 prill, CDC raportoi se një person në Teksas ka rezultuar pozitiv për virusin HPAI A(H5N1) por pavaresisht këtij fakti në njoftimin e saj CDC deklaroi se ky infeksion nuk ndryshon vlerësimin e rrezikut të shëndetit të njeriut nga gripi i shpendëve A(H5N1) për publikun e gjerë të SHBA-së, të cilin e konsideron të ulët. Megjithatë, njerëzit me ekspozim të afërt ose të zgjatur, të pambrojtur ndaj zogjve të infektuar ose kafshëve të tjera (përfshirë bagëtinë), ose në mjedise të kontaminuara nga zogjtë e infektuar ose kafshë të tjera, janë në rrezik më të madh për tu infektuar. Gjithashtu CDC ka dhënë rekomandime të përkohshme për parandalimin, monitorimin dhe hetimet nga ana e shëndetit publik të viruseve HPAI A(H5N1).